



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



## KPM V1-2015

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së KPM-2014/02, përkatësisht në nenin 4, paragrafi 7, në mbledhjen e mbajtur me datën 24 shkurt 2015, merr këtë:

### VENDIM

themelohet Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për radio të dorëzuara sipas konkursit publik të datës 26 dhjetor 2014.

### PËRBËRJA

Komisioni do të funksionojë në përbërje prej gjashtë (6) anëtarësh:

1. z. Luan LATIFI, Drejtor i Departamentit të Licencimit- Kryesues
2. znj. Anita MORINA SARAÇI, Anëtare e Komisionit, Anëtare
3. z. Nuredin ISLAMI, Udhëheqës i Divizionit të Licencimit- Anëtar
4. z. Besim GOVORI, Drejtor i Departamentit për Menaxhim Frekuencor, Anëtar
5. z. Mirand TAFARSHIKU, Udhëheqës i Divizionit për Monitorimi, Anëtar
6. znj. Ganimete NUÇI, Udhëheqëse e Divizionit të Financave

### VLERËSIMI

Vlerësimi i aplikacioneve për licencë do të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin e KPM-së, Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve dhe në pajtim me kriteret e Konkursit Publik të datës 26 dhjetor 2014.

### TERMET E REFERENCËS

Komisioni do të përcaktojë termat e referencës në takimin e parë që do të mbajë.

### ARSYETIM

KPM, me datën 26 dhjetor 2014, ka shpallur konkursin publik për dhënjen e frekuencave te reja për shërbimet mediale radio në 8 komuna të Republikës së Kosovës. Konkursi ka qenë publik deri me datën 26 janar 2015.

KPM, me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të pranuar gjatë konkursit publik, bazuar në nenin 4, paragrafi 7, të Rregullores KPM-2014/02, i cili parasheh formimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve, vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen vetëm për këto aplikacione.

Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave

data

26.02.2015